



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:014445 C. nr. 546/2010
Datë: 27.05.2024
Numri i dokumentit: 05739868

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, gjyqtari Atdhe Berisha, në çështjen kontestimore sipas padisë së paditësit Xh.K. nga Prizreni, kundër të paditurës L.T. nga fshati Komuna e Prizrenit, për anulimin e vendimit, jashtë seance, me datë 27 Maj 2024, morri këtë:

A K T V E N D I M

Shpallet jo kompetente Gjykata Themelore në Prizren.

Hedhet poshtë si e palejuar, padia e paraqitur në këtë çështje kontestimore.

A r s y e t i m

Paditësi me padinë e paraqitur kundër të paditurës, ka kërkuar nga gjykata të anulon aktvendimin e Komunës së Prizrenit, Komisionit për Vendosjen e Çështjeve Banesore nr. 360-281 datë 28.05.1995. si dhe të vërtetohet që është pronar i banesës e cila ndodhet në Prizren në lagjen

Gjykata gjatë ekzaminimit paraprak të padisë gjeti se për të vendosur në këtë çështje, nuk ka kompetencë lëndore. Gjykata konstaton se kjo çështje nuk hyn në kompetencën kontestimore por kemi të bëjmë me çështje juridike-administrative.

Anulimin apo prishjen e vendimeve të caktuara bëhet në procedurën e ankimit, ashtu që gjykata nuk mundet të anulon aktvendimin me të cilin një palë ka fituar të drejtën e shfrytëzimit të banesës kontestuese.

Në rast se pala paditëse pretendon që ka të drejtën e shfrytëzimit në banesën kontestuese, ka mundur që këtë çështje ta kërkon jo me kërkesë për anulimin e vendimit të Komisionit për Vendosjen e Çështjeve Banesore, por me kërkesë për blerjen e banesës sipas ligjit për Shitjen e Banesave për të Cilat Ekziston e Drejta Banesore.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendosë si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

C. nr. 546/2010 datë 27 Maj 2024

Gjyqtari,
Atdhe Berisha

UDHËZIME PËR ANKESË: kundër këtij aktvendimi, pala e pakënaqur mundet të paraqet ankesë, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate, në afat brenda 15 ditësh, pas pranimit të këtij aktvendimi.